



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi - Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe arsimi profesional

Varianti A

**Shënim:** Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

Rruga drejt diturisë

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë
Pyetja 8	D	1 pikë
Pyetja 9	B	1 pikë
Pyetja 10	B	1 pikë

**Pyetja 11** **1 pikë****Përgjigje:**Kundrinori: **rrugën**Lloji i tij: **i drejtë**

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen kundrinorin dhe thotë llojin e tij.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm kundrinorin.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 12** **1 pikë****Përgjigje:**Mbiemri: **të pafundme**

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen mbiemrin.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 13** **1 pikë****Përgjigje:**Gjymtyrët homogjene: **paqen, barazinë dhe drejtësinë.**

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen të gjitha gjymtyrët homogjene.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 14** **1 pikë****Përgjigje**Lidhëza bashkërenditëse: **dhe**

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen lidhëzën bashkërenditëse.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 15** **3 pikë****Model përgjigjeje:**

- **Ideja që parashtron autori në paragrafin e parë:** rruga për një të ardhme të ndritur është **sfidë dhe rrezik**, por edhe **mundësi e madhe**.  
OSE  
Rruga drejt së ardhmes është një periudhë e jashtëzakonshme me **ndryshime dhe zgjedhje**.
- **Hapat që ndiqen për të realizuar këtë ide:**

1. Duhet të kuptojmë **fuqinë tonë** të jashtëzakonshme. Të kemi **energji, dëshirë. Fuqia** është **armë për sukses**.  
 2. Është e rëndësishme të kemi një **qëllim të qartë**, vizion, frymëzim.

- 3 pikë** Nëse nxënësi përshkruan idenë dhe tregon dy hapat.  
**2 pikë** Nëse nxënësi përshkruan idenë dhe tregon vetëm njërin nga hapat.  
**1 pikë** Nëse nxënësi shkruan vetëm idenë.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi mund ta shkëpusë përgjigjen nga teksti ose mund ta perifrazojë atë. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë të gjitha përgjigjet e përafërta, të cilat janë shprehur e shkruar qartë nga nxënësi.*

**Pyetja 16****2 pikë****Model përgjigjeje:**

Karakteristikat gjuhësore:

- Përdorimi i vetës së parë. Për **ne** të rinjtë.
- Përdorimi i dendur i **foljeve** që tregojnë **veprime, ndjenja**: të kuptojmë, fillojmë, rrethon.
- Përdorimi i **foljeve në kohën e tashme: Kemi** një rol të madh, **të krijojmë**, është.
- Gjuha e përdorur është e ngjashme me **ligjërimin bisedor, e thjeshtë, e qartë dhe e prekshme**. Së dyti, është e rëndësishme të kemi që një qëllim të qartë.
- **Gjuhë inkurajuese dhe motivuese**: ne të rinjtë jemi të pajisur me energji të pafundme.
- **Fjali në formën e këshillave**, (është e rëndësishme të kemi një vizion të qartë), **postulateve**: (edukimi është drita që na udhëheq në rrugën tonë).

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen një karakteristikë gjuhësore dhe jep një shembull ilustrues.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm një karakteristikë gjuhësore.  
**0 pikë** Nëse përgjigjja është gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje tjetër që të çon te një karakteristikë gjuhësore e këtij teksti. Shembulli i vetëm pa dhënë karakteristikën nuk do të konsiderohet i saktë.*

**Pyetja 17****2 pikë****Model përgjigjeje:**

- **Analiza** duhet të fokusohet te **energjia, vizioni dhe dëshira**. Kjo do të shoqërohet me përvojë personale vëzhguese, me opinione të përdorur nga të tjerë shkrimtarë, filma, shprehje të njohura, libra etj, ose një mendim i përgjithshëm që të shpie në thelbin e shprehjes mbi karakteristikat e të rinjve sot.

**Psh:** Pjesa më e madhe e shoqërisë sot përqendrohet te **motivimi i të rinjve**, sepse ata jo vetëm janë pasuesit, e ardhmja, vazhdimësia, por ndërkohë **zotërojnë vetitë** për të cilat ka nevojë zhvillimi: **kanë energjinë**, e cila nuk duhet të shkojë dëm, kanë **vizion dhe ëndrra** të cilat është mirë të ndiqen e provohen. Mbi të gjitha kanë **dëshirë** dhe ndonjëherë mjafton vetëm dëshira për të qenë në gjendje të ndryshosh e t'ia fillosh nga e para.

**Ose**

- Çdo **ide e madhe** që të konkretizohet ka nevojë **për energji, vizion dhe dëshirë**. Po kështu edhe të jetosh jetën në mënyrë të plotë dhe të larmishme

**Ose**

- Duke e nisur nga vetja, kam mësuar se sot kam së pari **një ëndërr**, kam shumë **dëshira dhe energjia** nuk më mungon. Dua vetëm **një shtysë**, një xixë të vogël që këto të tria t'i bëj bashkë për jetën time.

**2 pikë** Nëse nxënësi analizon qartë dhe rrjedhshëm duke dhënë mendimin e tij.

**1 pikë** Nëse shpjegon në mënyrë të pjesshme përgjigjen.

**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo mendim të nxënësit të përafërt me modelet që lidhet me temën dhe që shpjegohet qartë e rrjedhshëm.*

---

**PJESA II****MIGJENI****BALADË QYTETSE**

Pyetja 18 C 1 pikë

Pyetja 19 C 1 pikë

Pyetja 20 A 1 pikë

Pyetja 21 A 1 pikë

Pyetja 22 D 1 pikë

Pyetja 23 A 1 pikë

Pyetja 24 C 1 pikë

Pyetja 25 A 1 pikë

Pyetja 26 B 1 pikë

Pyetja 27 D 1 pikë

## Pyetja 28

2 pikë

## Model përgjigjeje:

- Sfondi i natës ndihmon në përcjelljen e **mesazhit se jeta e kësaj gruaje është e rëndë** si pesha e errësirës së natës. Autori **denoncon** përmes sfondit të natës **indiferencën** shoqërore.
- Sfondi i natës, krijon **një efekt emocional** të fortë dhe **nxit përfytyrime të drejtpërdrejta dhe të figurshme**. Nata simbolizon **vetminë** dhe **braktisjen**.
- Sfondi i natës **krijon atmosferë të trishtuar, të rëndë, tepër pesimiste**, si vetë gjendja emocionale e gruas. I bën elementët e natyrës bashkëshoqërues, **spektatorë** dhe **indiferentë** e të ftohtë.
- Sfondi i natës është **një gjetje artistike** e Migjenit në funksion të mesazhit, **ironisë** dhe **revoltës** së tij.

**2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon sfondin të lidhur me atmosferën dhe me mesazhin.

**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon sfondin në funksion ose të vetëm atmosferës ose vetëm të mesazhit.

**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo mendim të nxënësit që jep mesazh dhe përshkruan atmosferën me fjalët e tij, në përputhje me atë që përcjell poezia.*

## Pyetja 29

3 pikë

## Model përgjigjeje:

- Detajet: Detajet e përdorura për të përshkruar gjendjen shpirtërore të gruas janë: fytyra e zbetë, sytë e zezë, buzët e vyshkura në vaj, plagët në gjoks, veshjet e grisura dhe shpirti i grisur, etj.

**3 pikë** Nëse nxënësi gjen tri detaje nga poezia.

**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy detaje nga poezia.

**1 pikë** Nëse nxënësi gjen një detaj nga poezia.

**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Vlerësuesi do të vlerësojë me pikë çdo detaj që jep gjendjen shpirtërore të gruas, të shkëputur nga poezia.*

## Pyetja 30

2 pikë

## Model përgjigjeje:

- Mjerimi fizik: **me kambë të zbathun**.
- Mjerimi shpirtëror: **me zemër të plasun**.
- Poeti e përshkruan gruan në dy plane: në atë të mjerimit fizik dhe atij shpirtëror. Vargu ku këto dy plane jepen të shkrira në një është: **“me veshje dhe me shpirt të grisun”**, ku jepet mjerimi fizik (veshje të grisun) e mjerimi ekstrem shpirtëror (shpirt të grisun).

**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy vargje: atë ku shprehet mjerimi fizik dhe vargun ku shprehet mjerimi shpirtëror i gruas.

**1 pikë** Nëse nxënësi shkruan vetëm njërin nga vargjet duke thënë edhe se kujt mjerimi i përket.

**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo detaj nga poezia që shpreh mjerimin fizik dhe shpirtëror të gruas. Detaji mund të merret dhe sillet nga poezia ose mund të perifrashohet nga nxënësi me fjalët e tij.*

*Shembulli konsiderohet i plotë kur jepet detaji dhe shkruhet se çfarë lloj mjerimi përshkruan, si në modelin më lart.*

## Pyetja 31

2 pikë

## Model përgjigjeje:

- Nëpërmjet këtij **kontrasti**, poeti kërkon të **theksojë** edhe njëherë **dramën e kësaj gruaje** që tashmë ka arritur në **një pikë kritike të mjerimit: atë të çmendurisë**.
- Vallëzimi i saj nuk është **vallëzim artistik**, por jehonë thotë autori për gjithë qytetin që të reagojë.
- Vallja e saj nuk është artistike, por **denoncuese** e një shoqërie në mjerim.
- Vallja e saj është shfrytëzim, vallja e saj është **pamundësi deri në vetëmohim**.
- Vallja e saj nuk është art i natyrshëm, por vallja e e **jetës së saj të çmendur**.

- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon përmes ndryshimit të valles artistike dhe valles së gruas domethënien e kontrastit dhe e shpreh atë qartë.
- 1 pikë** Nëse nxënësi e shpreh jo të plotë mendimin e tij.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shembull: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo shpjegim të përafërt dhe të qartë të këtij kontrasti në funksion të qëllimit të Migjeni.*

## Pyetja 32

3 pikë

## Model përgjigjeje:

## Drama e gruas:

- Drama e gruas qëndron në faktin se ajo **shet veten e saj fizike** në këmbim të sigurimit të jetës.
- Drama e saj qëndron edhe në faktin se **të gjithë e pranojnë në heshtje** veprimin e saj.
- Drama e saj shqetëson poetin se ajo po **kthehet në dukuri**.
- Drama e gruas qëndron në atë se ajo është **mjaft e dobët përballë mjerimit saj. Dikur atë e dëshironin të gjithë e sot askush**.
- Ajo ka mbetur **e varfër**, sepse i ka **humbur të gjitha huret** e saj dhe nuk mund t'i shfrytëzojë më ato **për të fituar jetesën**. Qyteti **nuk e ka parë atë kurrë si një qenie njerëzore**, por si një **objekt**. Këtë Migjeni e shpreh në vargjet:

(Dikur,  
kur gjit' e saj me kreni shpërtheheshin n'aromë,  
kur ish e njomë  
– atëherë e dashunojshin shum zotni.  
Jeta e saj është kjo valle e çmendun  
Vallzonte valle në rrugë të madhe/ me kambë të zbathun, me zemër të plasun.

- 3 pikë** Nëse nxënësi shpjegon saktë dramën e gruas dhe ilustron me dy shembuj.
- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon saktë dramën e gruas dhe jep vetëm një shembull.
- 1 pikë** Nëse nxënësi jep njërin nga tri gjërat që kërkohen: ose vetëm shpjegimin ose vetëm njërin shembull.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Komisioni i vlerësimit vlerëson çdo përgjigje të nxënësit, të përafërt me modelin e përgjigjes, ose çdo formë tjetër që i referohet pyetjes dhe shembujve nga teksti, të cilat mund të jenë vargje të shkëputura ose perifrastime të tyre, sjellë me fjalët e nxënësit.*

## Pyetja 33

2 pikë

## Model përgjigjeje:

## Fjalët kyçe:

- Dikur
- Sot

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy fjalët kyçe.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm njërin nga fjalët kyçe.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 34

3 pikë

## Model përgjigjeje:

Në strofën e fundit ndihet edhe **revolta e poetit**. Kjo revoltë është **jo e drejtpërdrejtë**, por shfaqet më shumë përmes fjalëve kyç: e çmendun, e fikun, e shterun, i molisun, e therun, një zâ vorri, një jehonë.

- 3 pikë** Nëse nxënësi shpjegon llojin e revoltës dhe jep dy shembuj.  
**2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon llojin e revoltës dhe jep vetëm një shembull.  
**1 pikë** Nëse nxënësi vetëm shpjegon llojin e revoltës.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë pozitivisht çdo përgjigje a formulim të nxënësit, që përafrohet me modelin tonë dhe që është në funksion të pyetjes mbi shpjegimin e llojit të revoltës apo shembujve nga teksti, të cilët mund të jenë rimarrë nga poezia ose mund të jenë perifrastuar nga nxënësi.*

## Pyetja 35

3 pikë

## Përgjigje:

Milosh Gjergj Nikolla lindi në Shkodër. Ai është autor i disa veprave si: vëllimi me poezi “Vargjet e lira” dhe i prozave të titulluara “Novelat e qytetit të veriut”.

- 3 pikë** Nëse nxënësi gjen dhe shkruan saktë tri pasaktësitë e fjalisë.  
**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dhe shkruan saktë dy nga pasaktësitë e fjalisë.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen dhe shkruan saktë një nga pasaktësitë e fjalisë.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 36 ese**

Për pjesën **ese** do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

**Shtjellimi i idesë****2 pikë**

- Nëse nxënësi shkruan një ese, ku **argumenton pse rruga drejt suksesit kalon së pari te besimi**. Pse duhet që të kemi besim kur vendosim të bëjmë diçka të rëndësishme, **pse duhet të kemi besim te vetja**, por edhe te të tjerët, pse **besimi është hapi i parë** pas idesë që ne kemi drejt një suksesi. Pse njeriu duhet **ta rikuperojë besimin** edhe kur gabon, pasi rruga për një sukses të caktuar në jetë, kalon edhe përmes dështimeve. Duhet të besojmë se ne mësojmë edhe përmes tyre. Mbi të gjitha duhet të besojmë se ne kemi brenda vetes ide, mundësi, aftësi për të krijuar, për të zbatuar, për të ndërtuar, për të komunikuar për sukses të vërtetë.
- Nëse nxënësi shpjegon pse **besimi është brenda nesh, por edhe edukohet nga familja, shkolla, mjedisi shoqëror**, etj.
- Nëse nxënësi **zërthen përmes detajesh** të ndryshme nga përvoja e tij, apo përvoja e leximit, njohjes, **lumturinë si koncept estetik, zërthen dhe mbështet idenë** me shembuj se **lumturia buron edhe nga arritje të vogla**, edhe nga ato që kanë rëndësi vetëm për ne, nga ato që i kemi zhvilluar me dëshirë, etj.
- Nëse nxënësi shtjellon ide të ndryshme mbi konceptin besim dhe lumturi, të cilat ndjekin radhën e argumenteve.
- **Nëse nxënësi sjell përvoja të ndryshme personale**, të cilat mbështetin bindshëm argumentin.

**Organizimi dhe struktura****2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje-zhvillim-mbyllje.
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

**Stili dhe origjinaliteti****2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me argumente, shembuj, që mbështetin temën dhe përmbajtjen.
- përdor detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

**Saktësia gjuhësore****2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

*Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysh, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i esesë është një nxënës dhe jo një shkrimtar.*